

TAKIM ME NAZIM EMINI, KRYETARIN E PORSAZGJEDHURTË  
KUVENDIT TË SHP KUMANOVË

# NJË SHTËPI TË PËRBASHKËT PËR TË GJITHË PENSIONISTËT

Në mbledhjen e parë konstitutive të SHP Kumamovë, që u mbajt në muajin maj të këtij viti, për kryetar të Kuvendit të Shoqatës së pensionistëve të Kumanovës u zgjodh Nazim Emini, delegati nga Dega e Likovës. Ky ishte rasti i drejtpërdrejtë që të takohemi me këtë pensionist, që të flasim për punën dhe aktivitetet që duhet të realizohen gjatë mandatit të tij katervjeçar.

**Kryetar Emini, në pajtim me ndryshimet statutore të SHP Kumanovë, për herë të parë që nga ekzistimi i Shoqatës eshtë futur funksioni i posaçëm i Kryetarit të Kuvendit, të cilin e zgjedhin delegatët në mbledhjen zgjedhore konstitutive. Cila ishte sfida që të pranoni këtë funksion vullnetar, dhe si u gjindët në fillim në rolin e udhëheqësit?**

Para se të përgjigjim drejtpërdrejtë në pyjeten tuaj, dëshiroj që në pikë të shkurtta që të arsyetoj motivin e kandidaturës sime për kryetar të Kuvendit, por edhe kushet që ishin vendimmarrës që të jem në krye të një organi të këtillë. Fillimisht të them se kam stazh prej 42 vitesh në procesin edukativ-vo-arsimor që do të thotë se kam punuar në funksion përgjegjës në edukimin dhe arsimimin e kuadrove të reja, dhe atë e kisha si pikë plus, që me pensionimin tim të vazhdoj me të njëtin ritëm të ak-

tiviteteve. Kjo do të thotë se menjëherë pas pensionimit tim u përfshiva aktivisht në punën e Degës së pensionistëve të Likovës, që ishte një prej degëve më të reja. Së bashku me kolegët e mi, atëherë pensionistë të rinj u angazhuam në të gjitha aktivitetet: kulturë, sport, ekskursione dhe kemi hapur dyert e Shoqatës sonë për anëtarë të rinj. Më duhet të thekson se ndihmë të madhe dhe mirëkuptim kemi patur nga udhëheqësia e atëhershme e SHP Kumanovë, që na i hapi dyert përbashkëpunim dhe na përfshijnë në të gjitha aktivitetet. Interesimi përtu përfshirë në këto aktivitete çdo ditë e më shumë rritet, që kontribuoi në hapjen e Degëve të reja në Sllupçan dhe Mateç. Gjatë zgjedhjeve të vitit 2019, u zgjodha delegat në Kuvendin e SHP Kumanovë, ndërsa duke patur parasysh se SHPK eshtë shoqatë multietnike me mbi 14.500 pensioniste, unë si anëtar aktiv u gjenda në listën e komisionit kandidues si kryetar i Kuvendit. Më duhet të theksoj se përmua votuan njëzëri të gjithë delegatët e pranishëm në seancë, që eshtë përlëvdatë, por paraqet edhe përgjegjësi që të punohet në mënyrë profesionale dhe me nderë, dhe e gjitha në interes të pensionistëve.

Më pyjet edhe se si u gjenda në rolin e kryetarit të Kuvendit të SHPK, që u mbajt më datë 22 mars

të vitit 2019. Më duhet të theksoj se në fillim nuk ishte lehtë, mbajtëm dy seanca, ku zgjodhëm edhe bartësit e funksioneve tjera udhëheqëse dhe anëtarët e Këshilit ekzekutiv. Seancat u mbajtën në atmosferë pune dhe në mënyrë demokratike, por arritëm të prekim të gjitha problemet dhe në pajtim me kriteret për zgjedhje të kuadrove, të zgjedhim edhe pensionistë që do të janë udhëheqës të SHPK. Për shkaqe subjektive, nuk arritëm që të zgjedhim delegatin e dytë në LSHPM, kështu që për herë të parë shoqata e pensionistëve të Kumanovës do të participojë në punën e LSHPM me një delegat. Unëjam optimist, dhe shpresoj që në seancën e ardhshme do të zgjedhim edhe një përfaqësues dhe do të mbyllim edhe këtë cështje.

**Zotëri Emini, Cilat janë planet e Juaja përmirësimin e punës së Kuvendit që vlen të theksohet se në pajtim me Statutin e ri të SHPK ka 35 anëtarë?**

Menjëherë pas pranimit të këtij funksioni me përgjegjësi, ndërmora hapat e nevojshme përealizimin e pandërprerë të aktivitetave të parapara me Statut. Kemi program përpunë, të përpiluar nga udhëheqësia e vjetër, i cili deri në fund të vitit do të plotësohet me aktivitete të reja përvazdimësi, përpunën ekonomike dhe me



përgjegjësi. Do të angazhohem për informim transparent dhe të rregullt të pensionistëve, posaçërisht kur të bëhet fjalë përtë hyrat si dhe të dalat e realizuara, që do të bëhen gjatë vitit. Posaçërisht do të kushtoj vëmendje akteve normative për shkak të realizimit të pandërprerë të punës së Shoqatës. Gjithashtu, do të angazhohem për realizimin e rezultateve pozitive në fushën e sportit, me përfshirjen e më shumë pensionistëve, për shkak të arritjes së rezultateve më të mira por edhe përkultivimin e frysës së sportit. Në planin e masivitetit do të duhet më shumë aktivitete në klubet e Degëve të pensionistëve, që nuk e arsyetojnë funksionin e tyre, aty pensionistët duhet të shqërohen, të argëtohen, të këmbejnë përvaja përcdo gjë, ata të gjeneratës së tretë. Mos të harroj, se edhe këtë vit do të tentoj që të mbajë në vazhdimesi orga-

nizimin e takimit multietnik në Likovë, i cili çdo vit e më shumë po fiton mbështetje më të madhe, dhe dua të përfshijë edhe pensionistët nga Gjilani, më mënyrë që të thellojmë bashkëpunimin në nivel ndërkombëtar.

**Dhe në fund, t'ju pyes se cila eshtë porosia e juaj për pensionistët?**

Kjo që duhet të theksohet me këtë rast eshtë se në të ardhmen duhet të gjithë së bashku të punojmë në përforcimin e lëvizjes së pensionistëve, të shoqërohem i gjithë së bashku pavarësisht interesave fetare dhe kombëtare, posaçërisht që të transmetojmë njohuritë tonë deri tek të rintjtë, t'i edukojmë me një frysë të tillë, se të gjithë kemi një shtëpi të përbashkët, dhe se vetëm me mirëkuptim mund të bëjmë të kemi jetesë më të mitë dhe më të burkur. Jasmina Todorovska

## REVYJA FOLKLORIKE REPUBLIKANE DHE GARAT RAJONALE BASHKUAN PENSIONISTËT

Në muajin qershor u mbajt revya e 9 republikane e këngës, muzikës dhe lojëra e një organizim të Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë, në të cilën morën pjesë mbi 1200 pensioniste nga i gjithë vendi, ndërsa e cila për herë të parë u mbajt nën mbësh-tetjen e Kryeministratës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev. Të pranishmëve iu drejtua kryetarja e Lidhjes, Stanka Trajkova dhe kryeministri Zoran Zaev. Në sallën e stërbushur u dëgjuan këngë, u vallëzuan valle dhe u shfa-qën tradita të pasurisë kulturore të të gjithëve që jetojnë në vendin tonë, e janë të pikturuara në folklo-rin tonë. Pas përfundimit të revysë, pensionistët u shoqëruan në kom-pleksin "New Star" ku i përshtëndëti ministria e punës dhe politikës sociale, Mila Carovska dhe shoqata-ve pjesëmarrëse iu shpërndanë falënderime.



Nga 21 maj deri më 23 qershor u mbajtën garat e 8 rajonale sportive të pensionistëve. Edhe këtë vit, garuesit garuan në të gjitha 11 disiplinat sportive në 23 kategoritë e parapara me Rregulloren për lojërat sportive. Edhe pse numri i ga-ruesve është vazhdimesh në rritje, vend për aktivitet nëpër shoqatët ka edhe shumë duke marrë parasy-

sh të dhënat që në garat rajonale mund të marrin pjesë maksimum 3 276 garues, ndërsa morën pjesë 2 147.

Vlen të theksohet që këtë vit, në Garat republikane të drejtë për shfaqje me garues të tyre siguruan me numër rekord 47 nga gjithsej 53 shoqata, gjë që nuk ka ndodhur deri tanë.



Duke i analizuar të gjitha akti-vitetet të cilat i paraprijnë garave rajonale si dhe përbajtja e vet garave mund të thuhet që garat e të gjitha niveleve nga viti në vit fitojnë kualitet dhe kuantitet e veçanërisht aty ku në të njëjtat ka përgatitje më të gjera më gjithëpërfshirëse.

Veçanërisht për theksim eshtë edhe fakti që në numrin më të

madh të garave rajonale ishin pre-zentë kryetarët ose përfaqësuesit e vetëqeverisjes lokale, të gjithë të cilët në fjalimet e tyre para publikut u shprehën pozitivisht përbashkë-punimin mes vetëqeverisjes lokale dhe shoqatave të pensionistëve dhe se gjithmonë u jepin mbësh-tetje dhe mirëkuptim në zgjedhjen e problemeve të tyre.

23.06.2019